

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË DEPARTAMENTIT
TË ADMINISTRATËS PUBLIKE PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET
PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Departamentit të Administratës Publike në garantimin e funksionimit të një administrate publike profesionale, të qëndrueshme dhe të bazuar në meritë në zbatim të legjislacionit të shërbimit civil;

Duke vlerësuar rëndësinë e reformës në administratën publike, në kuadër të procesit të integritetit evropian, forcimit të profesionalizmit, transparencës, llogaridhënies dhe eficiencës administrative;

Duke vlerësuar angazhimin e Departamentit të Administratës Publike, në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të burimeve njerëzore, zhvillimit të sistemeve digjitale dhe forcimit të kapaciteteve administrative në sektorin publik;

Duke vlerësuar përpjekjet për përmirësimin e procedurave të rekrutimit, zhvillimit profesional dhe monitorimit të zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil;

Duke vlerësuar bashkëpunimin institucional me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASP), institucionet e administratës shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore në funksion të forcimit të kapaciteteve profesionale të administratës publike;

Duke vlerësuar angazhimin në drejtim të modernizimit të administratës publike përmes zhvillimit të aftësive digjitale, përdorimit të platformave elektronike dhe rritjes së kapaciteteve në fushën e sigurisë kibernetike dhe teknologjive inovative;

Shqyrtoi veprimtarinë e Departamentit të Administratës Publike për vitin 2025 dhe vlerëson:

Vijimin e masave për forcimin e administrimit të shërbimit civil dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit për nëpunësin civil në institucionet e administratës shtetërore.

Angazhimin në drejtim të përmirësimit të proceseve të vlerësimit të performancës së nëpunësve civilë dhe zhvillimit të instrumenteve digjitale për administrimin e këtij procesi.

Vijimin e monitorimit të zbatimit të vendimeve gjyqësore për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues dhe ruajtjen e një niveli të lartë të zbatimit të tyre.

Përpjekjet për analizimin e proceseve gjyqësore që lidhen me rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë dhe evidentimin e problematikave të konstatuara gjatë këtyre proceseve.

Bashkëpunimin me institucionet e administratës shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore për ofrimin e asistencës në zbatimin korrekt të procedurave të shërbimit civil.

Vijimin e përpjekjeve për përmirësimin e procedurave të rekrutimit dhe reduktimin gradual të vendeve vakante në administratën publike.

Angazhimin në drejtim të konsolidimit dhe zgjerimit të përdorimit të sistemit HRMIS në funksion të përmirësimit të administrimit të burimeve njerëzore dhe automatizimit të proceseve administrative.

Angazhimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP) në zhvillimin e programeve trajnuese për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe digjitale të administratës publike.

Zhvillimin e trajnimeve në fushën e transformimit digjital, inteligjencës artificiale dhe sigurisë kibernetike për nëpunësit e administratës publike.

Thellimin e bashkëpunimit institucional të ASPA-s me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në funksion të shkëmbimit të praktikave më të mira dhe modernizimit të administratës publike.

Vijimin e përpjekjeve për forcimin e integritetit, profesionalizmit dhe qëndrueshmërisë së administratës publike, në përputhje me standardet e reformës së administratës publike dhe procesit të integritetit evropian.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që DAP-i për vitin 2026, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të vijojë përpjekjet për përmirësimin e procedurave të rekrutimit në administratën publike, me synim rritjen e nivelit të plotësimit të vendeve vakante dhe rritjen e përputhshmërisë së profileve të kandidatëve me kërkesat e pozicioneve.

2. Të vijojë konsolidimin dhe zgjerimin e përdorimit të sistemit HRMIS në të gjitha institucionet e administratës publike, në funksion të përmirësimit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe automatizimit gradual të proceseve administrative, përfshirë gjenerimin e centralizuar të listëpagesave të institucioneve, si dhe të sigurojë plotësimin, cilësinë dhe përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave në sistem, me qëllim përdorimin e tyre për planifikim strategjik dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë.

3. Të paraqesë një analizë më të detajuar mbi efektet administrative dhe financiare të riorganizimeve institucionale dhe reformave strukturore të ndërmarra në administratën publike.

4. Në bashkëpunim me ASPA-n, të vijojë përditësimin e programeve trajnuese në fushën e teknologjisë, transformimit digjital dhe sigurisë kibernetike, në përputhje me nevojat e administratës publike dhe prioritetet e transformimit digjital në planin vjetor të trajnimit për vitin 2026.

5. Të forcojë bashkëpunimin institucional me KMSHC-në në funksion të planifikimit vjetor të nevojave për rekrutim, përshkrimet e punës dhe administrimit të masave disiplinore.

6. Të informojë Kuvendin për ecurinë e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP) nga institucionet përgjegjëse sipas planit të veprimit përkatës, duke raportuar në mënyrë të veçantë mbi treguesit e performancës, masat e vonuara, nivelin e financimit dhe progresin në përmbushjen e angazhimeve të Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023–2030.

7. Të angazhohet në zhvillimin e një sistemi të avancuar të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së punonjësve të administratës publike mbi baza të matshme transparente, që të përdoret edhe për identifikimin e nevojave për trajnime shtesë.

8. Të përgatisë një analizë për ecurinë e proceseve gjyqësore të kthimit në detyrë të nëpunësve civilë, problematikat e konstatuara, përgjegjësitë e strukturave përgjegjëse në dhënien e masave disiplinore dhe ndjekjen e tyre në proceset gjyqësore, dhe përcaktimin e masave në këtë fushë.

9. Të forcojë masat për rritjen e integritetit të administratës publike, duke përfshirë programe trajnimi mbi etikën, konfliktin e interesit, Kodin Zgjedhor dhe komunikimin me publikun, si dhe të monitorojë funksionimin e këshilltarëve të etikës dhe zbatimin e standardeve të etikës në institucionet publike.

10. Të vlerësojë reflektimin e orarit fleksibël të organizimit të punës, në kuadër të procesit të rishikimit të kuadrit ligjor të shërbimit civil, si dhe sipas natyrës së funksioneve mundësinë e aplikimit të formave alternative të organizimit të punës, duke garantuar vijimësinë dhe eficiencën e ofrit të shërbimeve publike.

11. Të vijojë masat për unifikimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil, me synim krijimin e mundësive për lëvizjen e nëpunësve civilë ndërmjet administratës publike, njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të pavarura.

12. Të paraqesë një analizë për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare që lidhen me shërbimin civil dhe administratën publike, duke evidentuar masat e marra dhe sfidat e mbetura për forcimin e profesionalizmit dhe qëndrueshmërisë së administratës.

13. Të përfshijë në raportimin vjetor një analizë të plotë mbi ndikimin e riorganizimeve institucionale dhe ndryshimeve strukturore në administratën publike, duke evidentuar problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të tyre, si dhe të sigurojë paraqitjen e raportit vjetor dhe dokumentacionit përkatës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në vendimin e Kuvendit nr. 134/2018, “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”.

14. Të hartojë dhe të zbatojë mekanizma për planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë të nevojave për burime njerëzore në administratën publike, duke identifikuar pozicionet kritike

në nivelet drejtuese dhe masat për garantimin e vazhdimësisë institucionale, dhe ruajtjen e kapaciteteve profesionale.

15. Të forcojë transparencën dhe llogaridhënien institucionale përmes publikimit proaktiv dhe të përditësuar të informacionit publik, fuqizimit të kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për të drejtën e informimit, si dhe promovimit të standardeve të të dhënave të hapura për të garantuar aksesueshmëri, ripërdorim dhe komunikim efektiv me publikun.

16. Të vazhdojë të thellojë kapacitetet profesionale të administratës publike për procesin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian përmes programeve të dedikuara të rekrutimit, trajnimit dhe zhvillimit profesional.

17. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda tremujorit të tretë të këtij viti.

Miratuar në datën 30.6.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi